	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Page/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	1 / 14

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

Qëllimi i rregullores është që nëpërmjet përcaktimit të organizimit, funksionimit, detyrave, kompetencave, përgjegjësi, si dhe marrëdhënieve ndërmjet njësive të parashikuara në nenin përkatës të statutit të Kolegjit Universitar “Bedër” për sa i përket aspektit akademik, të krijojë një mjedis pune të rregullt dhe harmonik, me qëllim rritjen e rendimentit shkencor.

Kjo rregullore përcakton rregullat e formimit dhe të drejtimit, si dhe përgjegjësitë e rektoratit, fakulteteve, departamenteve dhe të qendrave të lidhura me to.

Neni 2

Shkurtime dhe përkufizime

Termet e kësaj rregulloreje të cilat gjenden në kolonën e majtë, kanë kuptimin e shprehur në kolonën e djathtë.

Bordi i Administrimit	:	Bordi i Administrimit i Kolegjit Universitar “Bedër”;
Senati	:	Senati i Kolegjit Universitar “Bedër”;
Rektor	:	Rektori i Kolegjit Universitar “Bedër”;
Rektorat	:	Rektorati i Kolegjit Universitar “Bedër”;
Statut	:	Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”;
NJSBC	:	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Neni 3

Rektori


1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit, si edhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori duhet të ketë titullin "Profesor" dhe dekretohet nga Presidenti i Republikës për një mandat 4- vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë në të njëjtin pozicion dhe institucion.

Neni 4

Funksionet dhe kompetencat e rektorit të Kolegjit Universitar “Bedër”

1. Rektori i Kolegjit ka këto funksione:
 - a. Drejton dhe përfaqëson Kolegjin në marrëdhënie me të tretët për çështjet akademike.
 - b. Është anëtar i Konferencës së Rektorëve.
 - c. Është kryetar i Senatit.
 - d. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese të njësive kryesore.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	2 / 14

e. Nënshkruan diploma për përfundimin e programeve të studimit, që janë organizuar në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe nuk mund ta delegojë këtë kompetencë.


2. Rektori i Kolegjit ushtron edhe këto kompetenca:

Propozon emrin e zëvendësrektorit/rëve për miratim në Senatin Akademik dhe e/i emëron atë/ata pas miratimit;

- a. Emëron dekanët e zgjedhur të fakulteteve;
- b. Emëron përgjegjësit e njësive bazë, të propozuar nga dekanët përkatës;
- c. Vendos për hyrjen e Kolegjit në lidhje me shkolla të larta të vendit dhe të huaja, shoqata e organizata të ndryshme, për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, si dhe për kualifikimin e punonjësve akademikë;
- d. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore, rektori urdhëron shkarkimin e tij;
- b) Cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të shkarkuar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, sipas këtij ligji;
- c) Rektori organizon zgjedhjet e zakonshme dhe të parakohshme;
- d) Miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit shkollor;
- e) Miraton punonjësit mësimorë shkencorë të cilët për vitin shkollor do të jenë nën ngarkesën vjetore të normës mësimore, duke e përcaktuar për çdo rast këtë ngarkesë;
- f) Emëron punonjësit mësimorë e shkencorë, drejtuesit e strukturave të administratës, si dhe specialistët e lartë, duke iu përmbajtur kritereve për zënien e këtyre vendeve, sipas përcaktimeve të njësive përkatëse, si dhe nënshkruan kontratat e punës së punonjësve të emërtësës së tij, sipas përcaktimeve të njësive përkatëse, si dhe i shkarkon ata në rastet e parashikuara me ligj, në përputhje me këtë Statut dhe akteve të tjera;
- g) Ngre komisione të cilëve iu ngarkon detyra të veçanta;
- h) Nxjerr urdhra të brendshëm për veprimtarinë e përditshme të administratës së Kolegjit, si dhe vendos masa disiplinore dhe administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin;
- i) Deleton firmën nëpunësve të tjerë në vartësi të tij, për kryerjen e detyrave të caktuara, kur e çmon të arsyeshme;
- j) Vendos përjashtimin nga Kolegji të studentëve për rastet e parashikuara në rregulloren përkatëse të studentëve;
- k) Jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Kolegjit dhe mund t'u bëjë apel këtyre forcave në rast nevoje;
- l) Rektori i Kolegjit kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akteve të tjera;
- m) Monitoron dhe apelon procesin e rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ;
- n) Përcakton dhe bën publike afatet, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ;
- o) Miraton përzgjedhjet e rekrutimeve dhe i çon për vendimmarrje përfundimtare në Senat;

Shpall fushatën e rekrutimeve me hollësitë e vendeve vakante

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Page/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	3 / 14

Neni 5

Këshilli i Profesorëve

Përbërja dhe funksionimi

Këshilli i Profesorëve përbëhet nga profesorë me kohë të plotë të cilët propozohen nga dekani dhe miratohen nga rektori.

Numri minimal i profesorëve të këtij këshilli duhet të jetë 7 (shtatë). Në rast se numri i profesorëve të institucionit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në këshillin e profesorëve mund të thirren deri në dy profesorë të fushave të njëjta nga institucione të tjera brenda ose jashtë vendit.

Drejtimi i Këshillit të Profesorëve bëhet me rotacion për dy vite akademike. Drejtuesi i këshillit zgjidhet nga i gjithë Këshilli i Profesorëve, duke siguruar 50%+1 të votave.

Funksionimi i këshillit të profesorëve bëhet sipas rregullores së propozuar prej tij dhe miratuar nga Senati.

Këshilli i Profesorëve ka këto detyra:

1. Vlerëson kërkesën e kandidatëve që kanë aplikuar për të mbrojtur doktoratën.
2. Vëzhgon dhe këshillon veprimtarinë e departamenteve përkatëse në procesin e organizimit dhe drejtimit të programeve të studimit të doktoratës.
3. Bazuar edhe në vlerësimin e departamenteve përkatëse miraton ose jo autoreferatin e disertacionit të një doktrate.
4. Miraton kandidatin fitues të programit të studimit të doktoratës.
5. Organizon dhe drejton kualifikimin shkencor pedagogjik pas doktoratës.
6. Bazuar në vlerësimin e departamentit përkatës, si edhe në gjykimin e tij për veprimtarinë mësimore e kërkimore të anëtarit të personelit akademik i propozon rektorit dhënien e titullit “Docent”.


Neni 6

Këshilli i Etikës

(Ndryshuar me vendim Senati nr. 02. ,datë 23.12.2020)

1. Këshilli i Etikës në Kolegjin Universitar “Bedër”, ngrihet me vendim të Senatit Akademik. Ky Këshill ka mandat 2- vjeçar, *me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë*. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë, të përzgjedhur nga punonjësit akademikë të Kolegjit.
2. Këshilli i Etikës ka si funksion kryesor diskutimin e problemeve që lidhen me etikën e jetës universitare në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe vendos rreth masave disiplinore. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje në lidhje me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
3. Këshilli i Etikës gjithashtu është organi përgjegjës për dhënien e masave disiplinore të propozuara nga autoritetet drejtuese ndaj stafit akademik, administrativ dhe studentëve, në rast mospërbushjeje të detyrimeve që burojnë nga ligji, statuti, rregulloret dhe udhëzime të tjera si brenda ashtu dhe jashtë institucionit, me përjashtim të largimit nga puna që është kompetencë vetëm e Bordit të Administrimit.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	4 / 14

4. Këshilli i Etikës merr vendime dhe i paraqet propozime rektorit të Kolegjit.

Neni 7

Funksionimi i Këshillit të Etikës

1. Këshilli i Etikës mbledhet sa herë që paraqitet një kërkesë për shqyrtim nga subjektet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
2. Kërkesa që paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Etikës përmban të paktën të dhënat e kërkuarit, një përshkrim të shkurtër të çështjes së shtruar për diskutim, si edhe materiale shoqëruese të cilat shërbejnë për shqyrtimin e çështjes.
3. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim kërkesa të paraqitura nga:
 - a) Senati Akademik;
 - b) Bordi i Administrimit;
 - c) Rektori;
 - d) Zëvendësrektori;
 - e) Dekani (ët);
 - f) Administratori i institucionit;
 - g) Të paktën 2 anëtarë të personelit akademik të Kolegjit.
4. Këshilli i Etikës funksionon dhe merr vendime, duke u bazuar në rregulloret e miratuara të institucionit.

Neni 8

Fakultetet

1. Fakulteti është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me llojin e institucionit të arsimit të lartë. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.
2. Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente.
3. Fakulteti miraton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, bazuar në propozimet e njësisë bazë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore.


Neni 9

Dekani

Dekani është autoriteti drejtues në një fakultet të Kolegjit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.

Dekani është personel akademik i kategorisë "Profesor".

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	5 / 14

Neni 10

Funksionet dhe kompetencat e dekanit

1. Dekani ka këto funksione:

- a. Drejton dhe përfaqëson fakultetin;
- b. Është anëtar i Senatit;
- c. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese, brenda fakultetit.
- d. Nënshkruan diploma për përfundimin e programeve të studimit, që janë organizuar në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe nuk mund ta delegojë këtë kompetencë.

2. Dekani ushtron edhe këto kompetenca:


- a. Propozon emrin e zëvendësdekanit për miratim në këshillin e fakultetit/dekanat dhe e emëron atë pas miratimit;
- b. Propozon drejtuesit e njësive bazë të fakultetit përkatës;
- c. Emëron përgjegjësit e grupeve mësimore lëndore dhe ndërlëndore mbi propozimin e titullarit të njësisë bazë;
- d. Organizon regjistrimin e studentëve, sipas programeve të studimit në fakultet, në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara për këtë qëllim;
- e. Mbikëqyr mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore dhe shkencore në njësitë bazë, duke koordinuar dhe bashkëpunuar me drejtuesit e njësive bazë;
- f. Miraton komisionet e provimeve të formimit, e mbrojtjes së diplomave për programet e studimit që mbulon dhe çdo komision tjetër në ndihmë të realizimit të detyrave dhe funksioneve të fakultetit;
- g. Në bazë të nevojave të fakultetit dhe zhvillimit të tij, i propozon rektorit vendet vakante dhe ndryshimet në numrin dhe pozicionet e burimeve njerëzore të fakultetit, për përgatitjen e procesit të rekrutimit;
- h. Ngre komisionin ad-hoc të rekrutimit për fakultetin përkatës;
- i. Drejton procesin e rekrutimit për fakultetin përkatës, në bazë të planit të rektorit për këtë proces;
- j. I propozon rektorit, për çdo vit akademik, listën e studentëve për t'u miratuar si të regjistruar për vazhdimin e studimeve në programet që mbulon fakulteti;
- k. I propozon rektorit përjashtimin e studentëve, për rastet e parashikuara në rregulloren e fakultetit;
- l. I paraqet Rektoratit, për çdo vit, raportin për aktivitetin mësimor, shkencor dhe financiar të fakultetit, pas diskutimit dhe miratimit paraprak në dekanat;
- m. Organizon konkurset e pranimeve të studentëve të rinj në fakultet dhe kontrollon mirëfunksionimin e komisioneve të pranimeve;
- n. Miraton rregulloret e brendshme të njësive në përbërje të fakultetit;
- o. Në bazë të numrit të studentëve dhe të angazhimeve të fakultetit i propozon rektorit hapjen e vendit dhe emrin për zëvendësdekan në fakultetin përkatës;

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	6 / 14

- p. Miraton kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të provimeve, të pranimeve, të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, tezat e provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe temat e projektdiplomave, projektet dhe planet e kërkimit të punonjësve shkencorë të qendrës përkatëse të kërkimit ose të njësisë bazë të mësim – kërkimit, pas shqyrtimit në dekanat, me propozim të titullarit të njësisë bazë;
- q. Shpall rezultatet e konkurseve të pranimit;
- r. Dekani në ushtrim të kompetencave, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
- s. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga titullari i një njësisë bazë apo Këshilli i Etikës, i propozon rektorit shkarkimin e tij. Rektori shprehet brenda një muaji.
- t. Dekani cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve kërkimore ose shkencore mësimore lëndore ose ndërlëndore, që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në emërimin e autoritetit të ri.
3. Dekani kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akteve të tjera.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	7 / 14

Neni 11

DEKANATI I KOLEGJIT

Përbërja e dekanateve të kolegjit

1. Dekanatet e Kolegjit Universitar “Bedër” janë organe kolegiale ekzekutive të njësisë kryesore përkatëse.
2. Dekanati përbëhet nga:
 - a. dekani;
 - b. zëvendësdekani;
 - c. përgjegjësit e njësisë bazë;
 - d. administratori i njësisë kryesore;
3. Dekanati thirret në mbledhjen e parë nga dekani.

Neni 12

Funksionet dhe detyrat e tjera të dekanatit

Funksionet e dekanatit janë si më poshtë:


- a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të njësisë kryesore;
- b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Rektorat dhe Senat;
- c) propozon kriteret për shpërndarjen e burimeve materiale dhe njerëzore akademike të njësisë kryesore;
- d) harton dhe propozon projektbuxhetin për njësinë kryesore;
- e) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
- f) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik.
- g) Funksionet e tjera të Dekanatit përcaktohen në rregulloren e tij si dhe në rregulloret e tjera të institucionit.

Neni 13

Mbledhjet dhe vendimmarrja e dekanatit

1. Dekanati mbledhet si rregull jo më pak se një herë në muaj. Në raste të nevojshme dekanati mund të mbledhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga dekani, kryesisht, apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të dekanatit.
3. Mbledhja konsiderohet e vlefshme, nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Page/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	8 / 14


4. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur, edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen për të cilën do të merret vendim.
5. Si rregull, dekanati merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur nuk mund të arrihet shumica, vota e dekanit është përcaktuese.
6. Procesverbali, i mbajtur në mbledhjen e dekanatit, përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.
7. Vendimet e marra nga dekanati, materializohen në formën e urdhrave të nxjerra nga dekani i njësisë kryesore.

Neni 14

Departamenti

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
2. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, në varësi të llojit të institucionit.
3. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.
4. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit.
5. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukurore të tij, sipas standardeve të cilësisë.
6. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.
7. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretë, si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.
8. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	9 / 14

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT / DREJTORI I QENDËRS KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 15

Përgjegjësi i departamentit / drejtori i qendrës kërkimore shkencore

1. Përgjegjësi i departamentit/ drejtori i qendrës kërkimore zgjedh zëvendësin e tij dhe njofton dekanin. Përgjegjësi i departamentit merr pjesë dhe përfaqëson departamentin në mbledhjet e Dekanatit. Ai mbikëqyr dhe kontrollon përmbushjen e detyrave nga ana e anëtarëve të tjerë të stafit akademik të departamentit. Në përfundim të vitit akademik, përgjegjësi i departamentit i paraqet dekanatit përkatës raportin mbi aktivitetin mësimor dhe kërkimor të departamentit për vitin e sapombyllur, si dhe planin e veprimtarive për vitin pasardhës.
2. Përgjegjësi i departamentit / drejtori i qendrës kërkimore shkencore është autoriteti drejtues i një njësie bazë në njësitë kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”.
3. Përgjegjësi i departamentit / drejtori i qendrës kërkimore shkencore duhet të jetë personel akademik i kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatë të kësaj kategorie, mund të kandidojë për drejtues edhe lektori, kur ky i fundit mban gradën shkencore “Doktor”.


Neni 16

Funksionet dhe kompetencat e përgjegjësit të departamentit / drejtorit të qendrës kërkimore shkencore

Përgjegjësi i departamentit / drejtori i qendrës kërkimore shkencore ka këto funksione dhe kompetenca:

- a) Drejton dhe përfaqëson njësinë bazë;
- b) Drejton e kontrollon gjithë punën mësimore-edukuese e shkencore në njësinë bazë;
- c) Evidenton për çdo semestër dhe vit akademik, në bazë të kriterëve ligjore, nevojat për staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme dhe ia parashtron këto nevoja dekanit përkatës dhe rektorit për të parashikuar rekrutimet e stafit akademik.
- d) Përzgjedh, në bashkëpunim me dekanin, në komisionin përkatës të rekrutimit, përmes një procesi të shpallur dhe transparent, kandidaturat për staf me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme në procesin mësimor.
- e) Merr masa organizative dhe monitoruese për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe kërkimor nga punonjësit e njësisë bazë që ai drejton;
- f) I propozon dekanit anëtarët e komisioneve të provimit të formimit apo edhe të mbrojtjes së diplomës për programet që mbulon njësi bazë e drejtuar prej tij;
- g) Nxit dhe motivon punonjësit në realizimin efikas të detyrave si në procesin mësimor, ashtu edhe në atë kërkimor-shkencor;

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	10 / 14

- h) Kërkon rishikime dhe përmirësime të programeve të studimit, të kurrikulave në bazë të nevojave dhe treguesve akademikë;
- i) I propozon dekanit përkatës procesin e zhvillimit të praktikave profesionale në shoqëri tregtare ose/dhe në institucione të tjera.
- j) I propozon dekanit kriteret për regjistrimin e studentëve, ndërsa ky i fundit i përcjell ato në Senat për miratim;
- k) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Kolegjit apo akteve të tjera.

Neni 17

Këshilli i departamentit

Këshilli i departamentit kryesohet nga përgjegjësi i departamentit dhe përbëhet nga zëvendësit e tij, nëse ka, dhe nga anëtarët e stafit akademik të departamentit.

Këshilli mbledhet periodikisht për të shqyrtuar temat e përcaktuara nga përgjegjësi i departamentit dhe ka këto detyra:

1. Nxit, bashkërendon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare, në dispozicion të departamentit;
2. Shqyrton planet mësimore dhe i propozon Dekanatit të Fakultetit ndryshimet përkatëse;
3. Shqyrton programet mësimore, bën ndryshimet e nevojshme dhe i propozon Dekanatit të Fakultetit ndryshimet përkatëse;
4. I propozon Dekanatit të Fakultetit tekstet mësimore në përdorim të studentëve;
5. Realizon programin mësimor sipas planit të miratuar dhe kontrollon cilësinë e mësimdhënies;
6. Përcakton tematikën e punës shkencore dhe kontrollon realizimin e saj;
7. Monitoron realizimin e kualifikimit shkencor pasuniversitar afatshkurtër dhe afatgjatë të stafit akademik;
8. Merr vendime në lidhje me transferimet e studimeve dhe bën njohjen e lëndëve dhe programeve mësimore dhe ia dërgon Fakultetit për dënim.


Neni 18

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit akademik

Detyrat dhe përgjegjësitë e këshilltarit akademik janë si më poshtë:

1. Për të ndihmuar nxënësit të regjistrohen në lëndët gjatë pararegjistrimit, regjistrimit dhe javës add and drop dhe t'i miratojë ato në fillim të çdo semestri.
2. Për të informuar dhe pajisur studentët e rinj me dokumentet që përmbajnë informacion, në lidhje me kalimin e lëndëve të nivelit parauniversitar dhe universitar, rregullat dhe rregulloret rreth provimeve dhe gjithashtu në lidhje me rregullat dhe rregulloret e tjera që kanë të bëjnë me studentët.
3. Për të qenë të vetëdijshëm për ndryshimet e bëra në rregulloret dhe të informojë nxënësit për këto ndryshime.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	11 / 14

4. Për të bërë të mundur që studentët të lexojnë përmbajtjen e lëndëve me zgjedhje apo lëndëve me zgjedhje joteknike dhe për të ndihmuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve të tyre, duke siguruar se ata nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të 45 ECTS krediteve për semestër.
5. Të pajisë studentët me informacion në lidhje me programet e shkëmbimit të studentëve jashtë vendit dhe sistemit të transferimit të krediteve (ECTS), duke u konsultuar me zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare të institucionit.
6. Për t'u siguruar studentëve informacionin në lidhje me të qenin i suksesshëm në klasë, kushtet për të marrë lëndë nga semestri i pestë gjatë programit Bachelor dhe për të përmbushur kreditet e përgjithshme ECTS, siç parashikohet në programin përkatës të studimeve.
7. Për të siguruar studentët me informacion në lidhje me kushtet që duhet për t'u diplomuar nga Kolegji Universitar "Bedër".
8. Për të siguruar studentët me informacion në lidhje me lëndët e detyruara siç përcaktohen nga departamentet përkatëse.
9. Për të përgatitur listën e kandidatëve që plotësojnë të gjitha detyrimet e diplomimit dhe të ia dorëzojë listën në fjalë përgjegjësit të departamentit përkatës.
10. Të informojë studentët e vitit të fundit që kanë jo më shumë se tri lëndë të ngelura që të përdorin të drejtën e tyre për të marrë provimin shtesë.
11. Për të siguruar orientimin e studentëve në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.
12. Për të siguruar informacion dhe orientim për studentët në njësitë përkatëse të institucionit për çështje që lidhen me akomodimin, bursat, çështjet shëndetësore dhe veprimtaritë jashtëshkollore.

Neni 19

Qendrat kërkimore dhe zhvillimore

Qendrat kërkimore-zhvillimore janë të organizuara pranë fakulteteve.

Qendrat kërkimore-zhvillimore kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi. Këto qendra marrin pjesë në veprimtaritë për realizimin e programeve të studimeve që ofron Kolegji Universitar "Bedër"

Qendrat kërkimore-zhvillimore marrin pjesë në realizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë.


Organizimi dhe funksionimi i qendrave kërkimore-zhvillimore përcaktohet në rregulloret specifike të tyre.

Neni 20

Dispozita të përbashkëta në lidhje me drejtuesit

Në raste të nevojshme, rektori mund t'i caktojë një personi më shumë se një detyrë drejtuese. Në rastet kur drejtuesi është në pamundësi për të ushtruar detyrën, cakton zëvendësit e tij për

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Page/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	12 / 14

ushtrimin e kompetencave, dhe në rast se dhe ky i fundit nuk mund t'i ushtrojë ato, drejtuesi mund të caktojë një anëtar të stafit akademik për ushtrimin e këtyre kompetencave.

Neni 21

Zyra e kërkimit shkencor

Zyra e kërkimit shkencor është ngritur me qëllim mbikëqyrjen e aktiviteteve të përgjithshme kërkimore në institucion. Zyra e kërkimit shkencor mbikëqyr procedurën e aplikimit dhe menaxhimit të projekteve kërkimore dhe harton planin strategjik të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës kërkimore.

Zyra e kërkimit shkencor harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në Kolegjin Universitar “Bedër” dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të tij të kërkimit. Zyra e kërkimit shkencor synon të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë impaktin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit.

Neni 22

Drejtori i zyrës së kërkimit shkencor

Drejtor i zyrës së kërkimit shkencor ushtron detyrën e tij, në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit nën varësinë e rektorit të Kolegjit Universitar “Bedër”. Ai emërohet nga rektori. Ai mban të paktën titullin “Doktor” ose diplomë ekuivalente në shkencat humane apo sociale, si edhe fusha të tjera, që lidhen me punën e Kolegjit Universitar “Bedër”.

Drejtori i zyrës së kërkimit shkencor drejton dhe mbikëqyr punën kërkimore në institucion, si dhe personelin e zyrës së kërkimit shkencor.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të zyrës së kërkimit shkencor janë:


1. Njohja e perspektivës dhe prioriteteve të Kolegjit Universitar “Bedër”, për të ndihmuar administrimin e institucionit në zhvillimin e strategjive të duhura në fushën e kërkimit.
2. Konsultimi me personelin akademik, drejtuesit, përgjegjësit e departamenteve për të identifikuar fushat e kërkimit, si dhe hartimi e zhvillimi i programeve të kërkimit.
3. Sigurimi i respektimit të standardeve profesionale dhe etike në fushën e kërkimit.
4. Zhvillimi, mbikëqyrja e politikave dhe procedurave të zyrës së kërkimit shkencor.
5. Njohja e mirë e qëllimeve dhe e arritjeve të institucionit.

Neni 23

Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare

Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare është ngritur me qëllim që t'u mundësojë studentëve dhe personelit akademik që të fitojnë eksperiencë ndërkombëtare në ushtrimin e veprimtarive kërkimore studimore, të ndihmojë studentët dhe personelin akademik që kanë ardhur nga universitetet jashtë vendit që të integrohen me programet mësimore të Kolegjit Universitar

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	13 / 14

“Bedër” si dhe duke përfituar maksimalisht nga projektet dhe programet ndërkombëtare në fushën e arsimit të kontribuojë në rritjen e cilësisë arsimore të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe të japë kontributin e saj në zhvillimin e shoqërisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare janë:

1. Zgjerimi dhe forcimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Kolegjit Universitar “Bedër”.
2. Zhvillimi i kontakteve me institucione arsimore ndërkombëtare dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të shkëmbimit dhe të bashkëpunimit me universitetet e huaja dhe institucionet e arsimit të lartë.
3. Në fillim të çdo viti akademik çdo departament cakton një asistent me vendim të Këshillit të Departamentit pranë kësaj zyre me qëllim që të ofrojnë konsulencën e tyre në mbarëvajtjen e veprimtarisë së kësaj zyre.
4. Organizimi i shkëmbimit të studentëve me universitete ndërkombëtare.
5. Inkurajimi i shkëmbimit të eksperiencave ndërkombëtare për studentët dhe stafin.
6. Plotësimi i kërkesave dhe nevojave të nxënësve e stafit që bëhen pjesë e programeve të shkëmbimit.
7. Organizimi i seminareve, konferencave dhe takimeve në lidhje me programet arsimore dhe kërkimore dhe gjetja e mundësive të financimit.

Neni 24

Drejtori i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare

Drejtor i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare emërohet nga Rektori.

Drejtori i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare drejton dhe koordinon punën e zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare; ai ushtron detyrën e tij në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit nën varësinë e rektorit të Kolegjit Universitar “Bedër”.

Neni 25

Zyra e koordinimit të programeve master


Zyra e koordinimit të programeve master është ngritur me qëllim koordinimin e punës të të gjitha programeve të ciklit të dytë, në përputhje me politikën e cilësisë së Kolegjit Universitar “Bedër”. Ndjek ecurinë e programeve të ciklit të dytë, përpilon strukturën e formularëve të nevojshëm, si dhe kontrollon vlefshmërinë e dokumentacionit të studentëve të ciklit të dytë.

Neni 26

Koordinatori i zyrës së koordinimit të programeve master

Koordinatori i zyrës së koordinimit të programeve master emërohet nga Rektori. Koordinatori i zyrës së koordinimit të programeve master ushtron detyrën e tij në bashkëpunim me njësitë e tjera të institucionit nën varësinë e rektorit të Kolegjit Universitar “Bedër”. Ai drejton dhe koordinon punën e zyrës së koordinimit të programeve master në bashkëpunim me koordinatorët e programeve të ciklit të dytë. Ai informon senatin akademik për mbarëvajtjen e programeve të ciklit të dytë.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	RREGULLORJA MBI ORGANIZIMIN AKADEMIK				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-002-AL	01.10.2012	0	0	14 / 14

Neni 27

Zyra e zhvillimit të kurrikulave

Zyra e zhvillimit të kurrikulës drejton zhvillimin e procesit kurrikular për të gjithë programet e reja dhe ekzistuese në Kolegjin Universitar “Bedër”.

Departamentet që dëshirojnë të krijojnë, ndryshojnë ose të mbyllin ndonjë program do të duhet të këshillohen së pari me zyrën e zhvillimit të kurrikulës. Propozimi për ndryshim apo krijimin e një programi të ri shtrohet në Departament, pas marrjes së informacionit të nevojshëm nga zyra e zhvillimit të kurrikulës.

Zyra e zhvillimit të kurrikulës ka përgjegjësinë të përditësojë ndryshimet kurrikulare në sistemin e menaxhimit të informacionit.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Senati Akademik.

Neni 29

Zbatimi

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga rektori i Kolegjit Universitar “Bedër”.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Zyra e Burimeve Njerëzore	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati